



**BULETINI I GRUPIT**

**H**  **ONA**





Autor: **HANDIKOS**



Zyra Qendrore: Rr. Dardania 4/7 D2 Prishtinë



[handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)




[www.handi-kos.org](http://www.handi-kos.org)

- Ky publikim është financuar nga Qeveria Suedeze me mbështetje të Save the Children. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi i saj. Qeveria Suedeze apo Save the Children jo domosdoshmërisht i ndan pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.



## PËRMBAJTJA

Qëllimi i buletinit .....	06	
RRETH GRUPIT “HËNA”.....	09	
MISIONI DHE VIZIONI I GRUPIT “HËNA”.....	11	
ANGAZHIMI I GRUPIT “HËNA”.....	13	
OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË GRUPIT “HËNA” .....	15	
AKTIVITETET E ORGANIZUARA ME GRUPIN “HËNA”.....	17	
AVOKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE .....	21	
STRATEGJIA E AVOKIMIT DHE PLANI I VEPRIMIT:.....	23	
TAKIME INFORMUESE NË 7 KOMUNA:.....	25	
TRAJNIMI MBI KONVENTËN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE.....	27	
TRAJNIMI MBI FUSHATËN SENSIBILIZUESE: .....	29	
TRAJNIMI MBI “HAPËSIRËN QYTETARE” .....	31	



## QËLLIMI I BULETINIT

- Qëllimi i këtij buletini është të fuqizojë fëmijët me aftësi të kufizuara përmes fëmijëve të Grupit Avokues “Hëna”, dhe t’i nxisë ata për vetë-avokim duke e inkurajuar pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset vendimmarrëse lidhur me çështjet që lidhen me të drejtat e tyre.
- Nëpërmjet këtij buletini, fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë pjesë e Grupit Avokues “Hëna” do të inkurajohen të bëhen pjesë e këtij grupi, të vendosin qëllime kuptimplota dhe të punojnë drejt krijimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse.



# H NA





# HONA

Gjilan  
Prishtinë

Ferizaj

Mitrovicë

Pejë

Drenas

Suharekë



## RRETH GRUPIT AVOKUESE “HËNA”

- Grupi “HËNA” është grup joformal avokues i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe është formuar në vitin 2017 nga HANDIKOS në bashkëpunim me Save the Children.
- Ky grup, aktualisht përbëhet nga rreth 200 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe aktualisht është aktiv në 7 Komuna të Kosovës- Prishtinë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Drenas, Mitrovicë dhe Suharekë.







## MISIONI DHE VIZIONI I GRUPIT “HËNA”

- Misioni: Avokim për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.
- Vizioni: Fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara trajtohen si qytetarë të barabartë në shoqëri.





## ANGAZHIMI I GRUPIT “HËNA”

- Deri sot, Grupi "Hëna" ka përfaqësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shumë panele vendore dhe ndërkombëtare, është angazhuar sidomos në fushën e ndërgjegjësimit për aftësinë e kufizuar dhe është përfshirë në të gjitha proceset që ka filluar HANDIKOS, e që prekin të drejtat dhe sfidat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vetëdijësimit dhe fuqizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara për mbrojtjen dhe avokimin për realizimin e të drejtave të tyre.






## OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË GRUPIT “HËNA”

- Si qëllim, grupi i ka caktuar vetes respektimin e të drejtave të këtij grupi të veçantë të fëmijëve. Arritja e këtij qëllimi do të bëhet përmes katër objektivave specifike.
  - 1. Rritja e pjesëmarrjes e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.
  - 2. Rritja e përkrahjes së institucioneve qeverisëse për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
  - 3. Ngritja e vetëdijes së shoqërisë lidhur me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.
  - 4. Sigurimi i gjithëpërfshirjes në klasa të rregullta për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara.





## AKTIVITETET E ORGANIZUARA ME GRUPIN “HËNA”


- Bashkë me fëmijët e Grupit “HËNA” deri më tani janë organizuar shumë aktivitete, duke përfshirë trajnime, punëtori, sesione informimi, fushata sensibilizuese, ndër to trajnime mbi Avokimin për të drejtat e fëmijëve, njohjen e Konventës mbi të drejtat e fëmijëve, punëtori mbi organizimin e fushatave sensibilizuese, trajnime mbi “Hapësirën Qytetare”, punëtori mbi Hartimin e Strategjisë dhe plani i veprimit, takime me përfaqësues të institucioneve dhe aktivitete të tjera të ngjashme.











## TRAJTIMI DY DITOR

### AVOKIMI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

- Pjesëmarrësit demonstruan një kuptim të qartë të koncepteve të avokimit;
- Pjesëmarrësit përmirësuan vetëbesimin dhe aftësinë për të folur në publik përgjatë dy ditëve të trajnimit;
- Pjesëmarrësit arritën që të zhvillojnë një fushatë konkrete të avokimit, duke identifikuar tema/problematika të cilat i hasin në hapësira ku jetojnë, duke përcaktuar audiencën, mesazhin kyç, kanalet e komunikimit, dhe mediumin përmes së cilit vendosën të avokojnë.
- Pjesëmarrësit arritën që të zhvillojnë komunikim interaktiv mes vete dhe të kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit për avokim efektiv.





## STRATEGJIA E AVOKIMIT DHE PLANI I VEPRIMIT:

- Strategjia e avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara është zhvilluar nga grupi “Hëna”, i cili përbëhet nga anëtarë nga komuna të ndryshme të Kosovës. Strategjia përmban një vizion të qartë dhe një mision të fuqishëm.
- Fëmijët e këtij grupi synojnë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në jetën publike.
- Strategjia fokusohet në rritjen e përkrahjes së institucioneve qeverisëse në nivel qendror dhe lokal për këtë grup fëmijësh dhe të rinjsh. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjisë është promovimi i ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me nevojat dhe mundësitë e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, duke parandaluar diskriminimin dhe duke inkurajuar përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe arsimore.





## TAKIME INFORMUESE NË 7 KOMUNA:

- Qëllimi i takimit të organizuar me fëmijët e grupit “Hëna” në 7 komuna të Kosovës (Prishtinë, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Drenas, Mitrovicë, Suharekë) ishte njoftim rreth fillimit të implementimit të projektit “Handikos for Child Rights” si dhe aktivitetet të cilat do të zhvillohen në kuadër të projektit.
- Fëmijët prezentë morrën pjesë në diskutim duke ndarë edhe përvojat e tyre të mëparshme me pjesëmarrësit e tjerë, lidhur me çështjet avokuese rreth të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.







## TRAJNIMI MBI KONVENTËN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE:

- Fëmijët pjesëmarrës patën mundësi të mësojnë më shumë rreth nocionit Konventë, historikun, rëndësinë dhe zbatueshmërinë e Konventës, si dhe lidhjen e saj me ligjet kosovare. Poashtu ata mësuan të drejtat specifike që garantohen nga Konventa, siç janë: e drejta për jetë, e drejta për familje, për arsim, për shëndet, për të mos qenë i diskriminuar, për privatësi, e drejta për të shprehur mendimin lirshëm, për të mos u detyruar për të punuar. Prej secilës nga këto të drejta, pjesëmarrësit u përfshinë në debat interaktiv, duke dhënë komente, mendime, opinione.





## TRAJNIMI MBI FUSHATËN SENSIBILIZUESE

- Fëmijët pjesëmarrës përmes këtij trajnimi, patën mundësi të mësojnë më shumë rreth fushatave sensibilizuese dhe fituan njohuri se si dizajnohen fushatat, duke përfshirë fazën prej ideimit e deri tek realizimi. Poashtu fëmijët patën mundësi që të propozojnë slogane dhe mesazhe për fushatë, duke mësuar se si përmes kreativitetit të tyre mund të avokojnë dhe përcjellin një mesazh






## TRAJNIMI MBI “HAPËSIRËN QYTETARE”

- Fëmijët pjesëmarrës përmes këtij trajnimi, mësuan rreth rëndësisë së hapësirës qytetare si dhe për rolin që kanë fëmijët si qytetarë aktivë.





## TAKIMI ME INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT”



Buletin i Grupit Hëna



# Fëmijë të dashur

- *Përkushtimi dhe puna e palodhur e juaja deri më tani janë vërtet për t'u admiruar*
- *Puna juaj përmes avokimit ka ndihmuar në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe ka luajtur një rol kryesor në ndërgjegjësimin për sfidat me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara*
- *Mezi presim të jemi dëshmitarë të rritjes dhe arritjeve tuaja të vazhdueshme në vitet e ardhshme përmes aktiviteteve të ndryshme që do të realizohen bashkë*
- *Prandaj Grupi Hëna mirëpret me shumë ngrohtësi edhe fëmijët e tjerë me aftësi të kufizuara që të bëhen pjesë e këtij grupi dhe të shëndërrsim bashkë drejt arritjes së qëllimeve tona të përbashkëta*





  *HANDIKOS*